



Newsletter, KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr.6 qershor 2019

Index:

Aktivitete 2

Aktivitete 4

Aktivitete 5

Poster sensibilizues 6

KOMISIONERI GAJDA NË KONSULTËN KOMBËTARE: REFORMA E AFTËSISË SË KUFIZUAR DHE DIALOGU ME GRUPET E INTERESIT



Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Robert Gajda mori pjesë në konsultën kombëtare Reforma e aftësisë së kufizuar dhe dialogu me grupet e interesit, organizuar nga shoqata e të Verbërve të Shqipërisë.

Konsulata përfshin diskutime me organizatat e aftësisë së kufizuar dhe aktorët e përfshirë në hartimin e reformës lidhur me transparencën e procesit për vendimarrjes. Komisioneri Dr. Gajda vuri në dukje rritjen e ankesave PAK në zyrën e KMD dhe trajtimin e tyre me përparësi të veçantë dhe nevojën për të thelluar bashkëpunimin në kuadër të promovimit të barazisë dhe mos diskriminimit.



Komisioneri Gajda Leksion të Hapur në Kolegjit Universitar të Biznesit



Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Robert Gajda zhvilloi një Leksion të hapur me studentët e Kolegjit Universitar të Biznesit, në Tiranë.

Gjatë bashkëbisedimit komisioneri Dr. Gajda prezantoi ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi, instancat e paraqitjes së një ankese dhe mënyra e trajtimit të saj, brenda afateve të përcaktuara në ligj, si dhe masat që merret nga institucioni i KMD kur konstaton akte diskriminimi. Komisioneri Gajda parashtroi rëndësinë e ligjit për mbrojtjen nga diskriminimi për sektorin privat.

Po ashtu, studentët u informuan për veprimtarinë e përditshme të KMD, stafit të saj dhe paraqitën interes për praktika profesionale mbi çështje të Drejtave të Njeriut pranë institucionit tonë dhe marrjen pjesë në seancat dëgjimore të hapura.

Fuqizimi i grave që nuk dëgjojnë në Shqipëri nëpërmjet informimit dhe rritjes së ndërgjegjësimit

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Robert Gajda mori pjesë në takim: "Fuqizimi i grave që nuk dëgjojnë në Shqipëri nëpërmjet informimit dhe rritjes së ndërgjegjësimit".

Në fjalën e tij, Komisioneri Dr. Gajda theksoi se është tashmë e domosdoshme "kalimi nga e përgjithshmja tek çështjet specifike. Kjo fal Organizatave ndërkombëtare në bashkepunim me shoqërinë civile. Nje aspekt i rendesishem eshte vazhdimesia e tyre, te jene projekte jo vetem ne start por edhe te jene aty ku nevojiten. Zyra e Komisionerit ka ne fokus implementimin e legjislacionit. Zbatimi i tij dhe plane veprimi qe shpesh krijojne edhe Nje mosbesim publik miratojme por nuk zbatojme. Sensibilizim dhe me shume Pergjegjegjesi. Nje perkujdesje me e madhe. Pushteti vendor duhet te jete me i zgjeruar ne komunitet si ne aspektin ligjor por dhe financues. Instrumentet ekzistojne, dhe me vjen mire qe ka nje vemendje te shtuar edhe fal punes se ANAD, por edhe nga organizata te tjera. Per ne si KMD ka diskriminim ne Informacion. Mos pasja e mungeses se komunikimit per individet qe nuk dëgjojnë".



Komisioneri Gajda në Konferencën Studimet gjinore, Ligji, Media dhe Shoqëria”



Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Robert Gajda mori pjesë në konferencën e VI Ndërkombëtare në Shkenca Humane, me temë: “Studimet gjinore, Ligji, Media dhe Shoqëria”, pranë Kolegjin Universitar “Bedër”.

Gjatë fjalës së tij, Komisioneri Gajda preku çështjet dhe aspektet ligjore në lidhje me gjininë. Ai theksoi rëndësinë e ligjit në këto çështje, duke e parë atë jo vetëm si detyrim, por edhe si kulturë jetese. Më tej ai u shpreh se ligji është i mirë por ka disa probleme në zbatim.

Konferenca mbledhi së bashku akademikë, studiues, ekspertë e profesionistë të fushave të ndryshme, të cilët ndanë eksperiencat dhe përfundimet e tyre kërkimore. Punimet e konferencës u përqendruan kryesisht mbi rolin e ligjit, medias dhe shoqërisë kundrejt barazisë gjinore.

Fëmijët brenda sistemit të Drejtësisë: Monitorimi i sistemit të mbrojtjes ligjore dhe aksesit të barabartë në drejtësi

Komisioneri për mbrojtjen nga Diskriminimi, Robert Gajda mori pjesë në forumin "Fëmijët brenda sistemit të Drejtësisë: Monitorimi i sistemit të mbrojtjes ligjore dhe aksesit të barabartë në drejtësi", të organizuar Qendra Shqiptare për Rehabilitimin e Traumës dhe Torturës (QSHRT) dhe Save the Children Albania.

Gjatë fjalës së tij, komisioneri Gajda vuri në dukje në sërë vendimesh të KMD përsa i përket rasteve të diskriminimit për fëmijë dhe rëndësinë e bashkëpunimit me njësitë e posaçme brenda njësive administrative pranë Bashkive për raportimin e situatave diskriminuese.



Diskriminimi në punë, gratë nuk denoncojnë nga frika



Gratë vuajnë nga diskriminimi në punë. Por ato kanë frikë të denoncojnë, për shkak të humbjes së vendit të punës. Kjo ka rezultuar nga një hulumtim i zhvilluar në internet nga Qendra e Aleancës Gjimore për Zhvillim, ku vlerësohet se ngacmimi seksual është shqetësimi kryesor në punë. Por ai nuk raportohet nga gratë dhe as denoncohet prej tyre, për shkak të frikës së papunësisë.

“Nga të anketuarit që thanë se kishin përjetuar ngacmime seksuale në punë, 39% e grave dhe 44% e burrave nuk kishin folur me askënd dhe nuk e kishin raportuar këtë eksperiencë”, u shpreh Mirela Arqimandriti, drejtore ekzekutive e qendrës Aleanca Gjimore për Zhvillim.

Diskriminimin në punë e vlerëson shqetësues edhe Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, i cili ka një propozim për bizneset. “Ne mendojmë që është shumë e nevojshme që bizneset private të kenë disa mekanizma të brendshëm për t’i trajtuar situatat diskriminuese”, tha komisioneri Robert Gajda.

Komisioneri Dr. Gajda gjatë fjalës së tij vuri në dukje rritjen e ankesave të diskriminimit mbi bazë gjinore në vendin e punës dhe mekanizmat e zyrës së KMD që janë përdorur për të luftuar fenomenin.



Ekspertët vlerësuan se nevojiten fushata ndërgjegjësimi për gratë që të denoncojnë këto raste, por edhe një bashkëpunim më i mirë mes institucioneve për ndëshkimin e tyre.



Diskriminimi për shkak të gjëndjes shëndetësore, në fokus të KMD



Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Roberts Gajda mori pjesë në punimet e Konferencës së parë Ndërkombëtare të Logopedisë dhe Fizioterapisë, që organizohet në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër Xhuvani".

Në fjalën e tij komisioneri Dr. Gajda falënderoi organizatorët për ftesën duke theksuar rolin e padiskutueshëm të profesionistëve të sektorit shëndetësor për të kuptuar nevojat e veçanta të personave me probleme artikulumit dhe që i trajtojnë sipas protokolleve mjekësore. Nevoja për të ofruar një shërbim të dedikuar dhe cilësor me qëllim gjithpërfshirjen e fëmijëve me nevoja të veçanta është mëse e domosdoshme.

Diskriminimi për shkak të gjëndjes shëndetësore, theksoi Dr. Gajda është një shkak që ndiqet nga zyra e KMD, me prioritet dhe rastet e evidentuara kanë marrë zgjidhje në përputhje me Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Diskriminimit për shkak të Moshës, seminar në Berlin

Stafi i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori pjesë në një seminar për rritjen e kapaciteteve për tu ballafaquar me fenomenin e Diskriminimit për shkak të Moshës, të organizuar nga Equinet në bashkepunim me Age Platform Europe, në Berlin, Gjermani.



#NOPLACE4HATE
#NOHATESPEECH

A person wearing a red and black striped beanie, a dark long-sleeved shirt, and blue jeans is sitting barefoot against a grey concrete wall. They are hunched over with their arms crossed and head buried in their arms. The wall has a white electrical outlet on the left. The floor is dark and reflective.

STOP GJUHËS SË URREJTJES!

Mendoje dy herë para se të thuash diçka jo të këndshme online. Edhe fjalët lëndojnë.

WWW.KMD.AL



Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi

Kreu i KMD:

Z. Robert Gajda

Komisioner për Mbrojtjen nga Diskriminimi

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi është institucion i pavarur i Republikës së Shqipërisë. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin. Ai mbështetet nga Zyra e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi (KMD), e cila ka personelin dhe pajisjet e nevojshme për të mbështetur Komisionerin në përmbushjen e detyrave të ngarkuara nga ligji nr. 10 221, datë 04.02.2010.

Për informacione të mëtejshme mbi aktivitetet:
www.kmd.al

Zyra qendrore e KMD

Rr: Rruga e Durrësit (Ish Ministria e Mjedisit)
Tirana, Albania
Zip Code: 1001
E-mail: info@kmd.al
Tel:
Komisioneri: + 355 4 243 1077
Ankesa: + 355 4 243 1078

Zyra rajonale:

Shkodër: Pranë Bashkisë Shkodër, Rr.13 Dhjetori, Nr.1
Zip Code: 4001
Tel: + 355 4 243 1078

Korçë: Pranë Bashkisë Korçë Rr:28 Nentori Nr.1
Zip Code: 7001
Tel: + 355 4 243 1078